



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 15.9.2023

Nr: 775

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 722, DATË 19.8.2023 "PËR CAKTIMIN E PARTIVE POLITIKE QË DO TË PROPOZOJNË ANËTARËT DHE SEKRETARIN E KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR NR. 11, PËR ZGJEDHJET E PJESHME PËR KRYETARIN E BASHKISË KUKËS TË DATËS 24 SHTATOR 2023"

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 186, datë 11.8.2023, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Kukës", të nenit 19, pikat 1, shkronja "n", dhe 2, nenit 29, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe vendimit nr. 35 datë 15.9.2023 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë

V E N D O S :

- Në vendimin nr. 722, datë 19.8.2023, bëhen këto ndryshime:
 - Shkronja "b" e pikës 1 ndryshohet si më poshtë vijon:
"b) Dy anëtarë propozohen nga Partia Demokratike (PD);"
 - Shkronja "c" e pikës 1 ndryshohet si më poshtë vijon:
"c) Një anëtar propozohet nga Partia e Lirisë (PL)."
 - Pika 5 ndryshohet si më poshtë vijon:
"5. Sekretari i KZAZ-së do të propozohet nga Partia demokratike."
- Partia Demokratike dhe Partia e Lirisë të sjellin propozimet për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-së jo më vonë se data 18 Shtator 2023.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Data: 15.9.2023 Nr: 775
Ora: 12:00



"Për disa ndryshime në vendimin nr. 722, datë 19.8.2023 "Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 11, për zgjedhjet e pjeshme për Kryetarin e Bashkisë Kukës të datës 24 shtator 2023"

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 15.9.2023 Nr: 775
Ora: 12:00



“Për disa ndryshime në vendimin nr. 722, datë 19.8.2023 “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 11, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Kukës të datës 24 shtator 2023”